

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

- miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
- zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
- emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
- miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve; subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë; duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar; kushtet e parashikuara në nenin 49 ligjit Nr. 139/2014 "Për Vetëqeverisjen Vendore";
- vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.
- vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi
- vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve
- vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë
- vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet

- zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre,
- vendos për dhënien ose deklarin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë
- miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;
- vendos për simbolet e bashkisë;
- vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
- jep tituj nderi dhe stimuj;